




KONTRATA SOCIALE



ELBASAN



KONTRATA SOCIALE



Rr. "Abdyl Frasheri"
Pallati 1/10, shk.1, ap.3 Tirane
+355 4 22 555 14
+355 69 61 20 169
perballjaofertavepolitike@gmail.com
www.popnetwork.al
POPNetworkAlbania
POPAlbania2020
pop_perballjaofertavepolitike

Rreth Projektit

Përballja e Ofertave Politike – POP, është nismë e një rrjeti organizatash të shoqërisë civile shqiptare. POP synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për deputetë dhe për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien gjatë zgjedhjeve dhe periudhës pas tyre.

POP është zbatuar suksesshëm gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2013, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2015, Zgjedhjeve Parlamentare 2017, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2019 dhe Zgjedhjeve Parlamentare 2021. Kjo nismë është mbështetur dhe mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme dhe National Endowment for Democracy.

POP 2021 organizohet në Bashkitë Durrës, Fier, Kamëz, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Korçë, Elbasan dhe Vau i Dejës, aty ku organizatat e rrjetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

POP synon:

Nxitjen e dialogut mes zgjedhësve dhe kandidatëve për Zgjedhjet Parlamentare 2021, por edhe ndërmjet vetë kandidatëve, duke shërbyer si një platformë diskutimi, ku kandidatët mbahen të përgjegjshëm ndaj premtimeve të tyre, si dhe fuqizimin e OSHC-ve të ndryshme për të monitoruar dhe advokuar pranë bashkive për zbatimin e kornizës ligjore dhe përmbushjen e prioriteteve të kontratës sociale.

Objektivat specifike POP-2021:

- Forcimi i rrjetit POP duke u zgjeruar me organizata të reja që mbulojnë bashki të tjera.
- Forcimi i marrëdhënieve midis qytetarëve, POP dhe aktorëve të tjerë në shoqëri.
- Monitorimi, raportimi dhe veshja me përgjegjësi e drejtuesve në nivelin lokal për të përmbushur kontratën sociale në secilën bashki.

Përmes mjeteve të advokimit / lobimit rrjeti POP do të punojë për të arritur rezultate, duke siguruar që kontratat sociale të mos jenë thjeshtë një zotim i shkruar, por një angazhim i vazhdueshëm për kryetarët e bashkive.

POP vazhdon të monitorojë Kontratat Sociale realizuar gjatë vitit 2019, dhe gjatë vitit 2021 vjen me realizimin e Kontratave Sociale për 3 bashki të tjera, Korçë, Elbasan dhe Vau i Dejës, si rezultat i zgjerimit të tij me 3 organizata të reja që operojnë në këto bashki.

Në lidhje me Zgjedhjet Parlamentare 2021, rrjeti POP ka informuar dhe vazhdon të informojë qytetarët duke përdorur mediat sociale në lidhje me premtimet dhe përparësitë e kandidatëve dhe partive politike përkatëse, premtime të bëra prej tyre në prag të këtyre zgjedhjeve, si dhe në lidhje me punën që do të kryejnë të zgjedhurit për t'i përmbushur ato. Përveç kësaj, faqja online interaktive, ju ofron qytetarëve shqiptarë një paraqitje shumë të nevojshme të ofertave të partive politike. Kjo kontribuon për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies të të zgjedhurve gjatë fushatës elektorale, por edhe gjatë mandatit. Aktivitetet e organizuara në kuadër të POP, ofrojnë mundësi të paanshme dhe të barabarta për të gjitha palët dhe kandidatët në dhënien dhe paraqitjen e objektivave dhe platformave të tyre politike për qytetarët. Diskutimet midis kandidatëve nga parti të ndryshme nxisin politikanët të komunikojnë në mënyrë qytetare me njërit-tjetrin, si dhe synojnë të japin një shembull të mirë për publikun e gjerë në lidhje me kuptimin dhe mbështetjen që politikanët i ofrojnë komuniteteve të tyre pavarësisht bindjeve politike. Në qendër të të gjitha aktiviteteve të POP do të jenë qytetarët me nevojat dhe shqetësimet e tyre.

Gjatë periudhës parazgjedhore për vitin 2021, zhvendosja e debatit publik nga politika drejt platformave politike ishte shumë e rëndësishme. POP iu dha një mundësi partive politike që të paraqisnin programet e tyre dhe të tregonin se sa do të kujdesen për qytetarët në katër vitet e ardhshme. Premtimet e partive politike dhe programet e tyre do të vazhdojnë të monitorohen pas Zgjedhjeve Parlamentare 2021 nga Rrjeti i Organizatave të POP dhe grupet e qytetarëve që do të organizohen nga ky rrjet.

ORGANIZATAT E RRJETIT POP

- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës
- Qendra Rinore Vlorë
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz
- Qendra "Epoka e Re", Fier
- Shoqata "Intelektualët e Rinj Shpresë", Shkodër
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë
- Qendra Rinore për Progres, Kukës
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec
- Shoqata Tjetër Vizion, Elbasan
- Shoqata Gruaja në Zhvillim Korçë, Korçë
- Qendra Sociale Hapa të Lehtë, Vau i Dejës.

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE

Banorët e Bashkisë Elbasan u përfshinë në 6 forume të zhvilluara gjatë muajit maj 2021, me qëllim identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor sipas këndvështrimit qytetar. Në secilin prej 6 forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, me nivele të ndryshme arsimore, si dhe individë që i përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shëndetësor.

Pjesëmarrja sipas gjinive

Burra	60.5 %
Gra	39.5 %

Në secilin prej forumeve të zhvilluara, qytetarët diskutuan gjerësisht mbi 26 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore, të cilat ndikojnë drejtëpërdrejtë në komunitetin vendor:



Shërbimet publike



Zhvillimi ekonomik vendor



Dimensionimi social



Demokracia vendore

Për secilën prej çështjeve objekt diskutimi, qytetarët paraqitën këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi çështjet që përbëjnë prioritet për ta e për rrjedhojë duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendorë.

Në bazë të vlerësimit të vetë pjesëmarrësve, prioritetet e komunitetit u organizuan në tre grupe:

1. **Ndërhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;
3. **Vijueshmëri**, përfshin çështjet të cilat kanë arritur zhvillimin e pritshëm nga komuniteti dhe për to nevojitet vetëm ruajtje e të njëjtit standart nga të zgjedhurit vendorë.



21 është numri i prioriteteve të vendosura nga komuniteti, të prezantuara më hollësisht në vijim, sipas shkallës së rëndësisë. Për të gjitha këto do të llobohet që të jenë pjesë e axhendës së të zgjedhurve të rinj vendorë, po ashtu edhe përmbushja e tre të monitorohet në vijim nga vetë komuniteti.

Grupi i parë / NDËRHYRJE PRIORITARE

Janë **9 çështjet** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë shumë prioritare.

SHËRBIMET PUBLIKE

- Infrastruktura, rrugët kryesore;
- Furnizim me ujë dhe kanalizime;
- Koshat e plehrave;
- Shkollat 9 vjeçare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

- Nxitja e bizneseve të rinjve dhe grave;
- Nxitja e punësimit;
- Ngritja e një fabrike të përpunimit të prodhimeve fruta/perime;
- Rishikimi i nivelit të taksave/tarifave në raport me shërbimin.

DEMOKRACIA VENDORE

- Dokumenta dhe informim.

Grupi i dytë / NDËRHYRJE DISI PRIORITARE

Janë **6 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë disi prioritare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

- Njoftimi i qytetarëve mbi detyrimet për taksat/tarifa.

SHËRBIMET PUBLIKE

- Ndriçimi;
- Rrugët ndërmjetëse;
- Kanalet kulluese/vaditëse;
- Transporti publik.

DIMENSIONI SOCIAL

- Pjesëmarrja e grave në vendimarrje.

Grupi i tretë / NDËRHYRJE VIJUESE

Janë **7 çështje** që kanë marrë vlerësimin më të lartë nga pjesëmarrësit në Forume.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

- Takime publike për buxhetin;
- Pagesa e taksave.

SHËRBIMET PUBLIKE

- Pyjet dhe kullotat.

DIMENSIONI SOCIAL

- Informimi dhe komunikimi;
- Transparenca në vendimarrje;
- Pjesëmarrja në vendimarrje.

SHËRBIMET PUBLIKE

INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE

Në të gjitha forumet u nënvizua situata e kënaqshme me rregullimin e rrugëve kryesore, por ka problem në rrugën kryesore të Njesisë Administrative Funar si dhe rrugët dytësore dhe brendësitë e lagjeve. Prioritetet e listuara i përkasin vetëm një rruge kryesore dhe një dytësore si dhe përmirësimeve të ndryshme infrastrukture.

Prioritet 1. Ndërtimi i rrugës kryesore që lidh Bashkinë me Njësitë Administrative dhe vijimi i investimeve që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për secilën Njësi.

Njësia Administrative Funar ka përcaktuar si prioritet kryesor rrugën kryesore që lidh Njësinë me Bashkinë Elbasan;
Njësia Administrative Funar - Rikonstruktimi i urës së fshatit;
Njësia Administrative Shushicë - Rikonstruktimi i rrugës së Shelcanit;
Njësia Administrative 1 - Pajisja me ndriçim e rrugës kryesore;
Njësia Administrative 1 - Pastrimi i rrugëve të lagjeve nga ferrat;
Njësia Administrative 1 - Rikonstruksioni i rrugës së ish konservimit dhe lidhja e saj me unazën.

FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET

Prioritet 2. Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për secilën prej njësive vijuese.

Përfaqësuesit e komunitetit në të gjitha Njësitë theksuan se, dhe pse Bashkia ka bërë investime të pjesëshme për të zgjidhur problemet me ujin e pijshëm dhe kanalizimet, ato duhet të bëjnë akoma më shumë punë për të arritur nivelet e duhura në këtë çështje.

Njësia Administrative Shirgjan - Ka zona ku furnizimi me ujë të pijshëm mungon;
Njësia Administrative Paper- Mungon furnizimi me ujë në fshatin Lugës dhe Murras;
Në lagjen "28 Nëntori" - ka pallate që nuk kanë ujë të pijshëm;
Njësia Administrative Funar - Ka ujë 24 orë, por sistemi i ujit të pijshëm duhet të rikonstruktohet;
Njësia Administrative Shirgjan - Mungon uji për vaditje.

KOSHAT E PLEHRAVE

Prioritet 3. Përmirësimi i cilësisë së pastrimit sipas njësive.

Njësia Administrative Papër - Mungojnë koshat për grumbullimin e plehrave;
Njësia Administrative Funar - Mungojnë koshat e plehrave;
Njësia Administrative 1- Kosha plehrash ka, por janë larg vendeve të banimit;
Njësia Administrative 1 - kërkohet të zgjidhet problemi i pastrimit ditët e festave, pasi punëtorët nuk pastrojnë dhe rritet ndotja.

SHKOLLA 9-VJEÇARE

Prioritet 4. Ngritja e shkollave të reja, në veçanti në qytet, ku numri i nxënësve në klasë është shumë i lartë.

Pjesëmarrësit në fokus -grupe theksuan nevojën për të shtuar numrin e shkollave dhe rikonstruksionin e atyre të mbetura pa ndërhyrje, pasi numri i nxënësve në klasa është shumë i lartë dhe si rrjedhojë bie cilësia e mësimi.

Njësia Administrative 1 - Rikonstruktimi i shkollës "Abdyl Paralloi"



ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

NXITJA E BIZNESEVE TË TË RINJVE DHE GRAVE

Prioritet 5. Nxitja e bizneseve të të rinjve dhe grave.

Të pranishmit theksuan faktin që numëroheshin pak të rinj apo gra që ishin ndihmuar nëpërmjet nxitjes për hapjen e bizneseve të reja dhe forcimin e atyre ekzistuese. Kërkohej një informim më i gjerë i grave dhe të rinjve mbi programet për nxitjen e biznesit dhe procesin e aplikimit për t'u përfshirë në këto programe.

NGRITJA E NJË FABRIKE TË PËRPUNIMI TË PRODHIMEVE FRUTA/PERIME

Prioritet 6. Fabrikë përpunimi të prodhimeve fruta/perime.

Nga diskutimet u pranua fakti i shtimit të prodhimit vendas. Një pikë për t'u theksuar ishte hapja e fabrikave të përpunimit të frutave dhe perimeve në zonat si Shushicë, Papër etj. Bashkia Elbasan nuk e ka detyrë funksionale ndërtimin e fabrikave të përpunimit të produkteve të brendshme, por mund të nxisë me lehtësira fiskale biznesin e mesëm dhe të madh në mënyrë që të ndërtojnë të tilla fabrika, për të mundësuar edhe hapjen e vendeve të reja të punës.

DIMENSIONI SOCIAL

DOKUMENTA DHE INFORMIM

Prioritet 9. Dokumenta dhe informim

Në forumet e Njesisë Nr.1 në Elbasan, pjesëmarrësit theksuan faktin se dokumentat e kërkuara në Bashki, vonohen dhe nga personeli përgjegjës duke e bërë kështu shumë të vështirë pajisjen me to. Në disa raste, informimi për pjesëmarrje në takime publike mbi shërbimet publike mungon, informacioni merret nga të afërm por jo nga punonjësit e Bashkisë, të cilët e kanë për detyrë të informojnë.

NXITJA E PUNËSIMIT

Prioritet 7. Nxitja e punësimit

Bashkia duhet të bëjë më shumë për nxitjen e punësimit. Sidomos për;

- të rinjtë e sapo diplomuar;
- grupmoshën 50–65vjeç;
- të arsimuarit me shkollë të mesme, të paarsimuarit dhe ata pa një profesion;
- Gratë kryefamiljare;
- Gratë viktimë të dhunës në familje;
- Anëtarët e komunitetit rom.

NIVELI I TAKSAVE NË RAPORT ME SHËRBIMET QË OFROHEN

Prioritet 8. Niveli i taksave/tarifave në raport me shërbimin.

Pjesëmarrësit në forume u shprehën se taksat janë të larta dhe nuk justifikojnë shërbimin apo cilësinë e tij. Në mënyrë të veçantë tarifat e ujit të pijshëm nuk i përgjigjen cilësisë dhe shërbimit. *"I paguajmë detyrimet, por faturat nuk na vijnë nëpër shtëpi. Nuk jemi të kënaqur me shërbimin, sidomos me ujin, taksa e të cilit është shumë e lartë".*

POP

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

NJOFTIMI I QYTETARËVE MBI DETYRIMIN PËR TAKSAT/TARIFAT

Prioritet 10. Ngritja e një sistemi të unifikuar që mundëson marrjen e njoftimit në banesë mbi detyrimin për taksat/tarifat.

40% e komunitetit të përfshirë në forume u shpreh se merrnin njoftim në banesë për detyrimin për taksat/tarifat. Pjesa tjetër u shprehën se duhet të interesoheshin vetë pranë pikave ku kryhen pagesat.

SHËRBIMET PUBLIKE

TRANSPORTI PUBLIK

Prioritet 11. Vendosja e autobuzëve në linjat e Njësive Administrative Papër, Funar, Shushicë si dhe publikimi në stacion i orareve të mbërritjes dhe nisjes së autobuzëve.

Probleme me transportin u raportuan nga të tre njësitë administrative Papër, Funar dhe Shushicë, ku mungon transporti publik dhe lëvizjet realizohen me transport privat (furgonë). Ndërsa në qytet banorët shprehen që ekziston transport publik, por kushtet janë shumë të këqija, autobuzët janë të vjetër dhe kushtet higjienike mungojnë.

INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE

Prioritet 12. Adresimi me prioritet i ndriçimit në rrugët e brëndshme të lagjeve të Njesisë - qytet.

Ndriçimi ekziston vetëm në qendër si në Njësitë Administrative edhe në Qytet, ndërsa, nëpër lagje është pothuajse inekzistent.

Prioritet 13. Vijimi i investimeve që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore në secilën Njësi.

Në Njësitë Administrative rrugët dytësore mbeten problematike, pasi nuk është investuar ndërkohë që nuk mirëmbahen as ato ekzistueset.

Prioritet 14. Pastrimi i kanaleve vaditëse në njësitë Administrative Papër, Shushicë, Shirgjan.

Një problematikë në këto njësi mbetet mosmirëmbajtja në mënyrë të vazhdueshme dhe mos pastrimi i tyre në sezonet e pranverës dhe vjeshtës. Ndaj kërkohej nga Bashkia që këto punime të bëhen me mjete të përshtatshme.



ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

Takime publike për buxhetin

Në të gjitha forumet u theksua se, takimet për buxhetin ishin të përvitshme dhe kjo praktikë duhet të vijojë të ndiqet nga Bashkia.

Pagesat e taksave nga qytetarët

Të gjithë pjesëmarrësit në forume u shprehën se i paguanin taksat.

Ndërsa në njërin prej forumeve pjesëmarrësit u shprehën se shikojnë që taksat nuk mbledhen kudo njësoj. Në këndvështrimin e tyre, periferia abuzon ndërsa zona qendrore paguanjë çdo gjë, ndërkohë që edhe investimet më të shumta i marrin ato zona ku paguhen më pak taksat.

SHËRBITIMET PUBLIKE

PYJET DHE KULLOTAT

Në njësitë administrative rurale, diskutimi në lidhje me këtë çështje, pjesëmarrësit e fokusuan më së shumti tek përdorimi i drurit për ngrohje. Në Papër shqetësimi i vetëm ishte çmimi i drurit të zjarrit që vlerësohej i lartë. Gjithashtu shqetësim mbetet ruajtja e zonave që kanë pyje e kullota vetëm nga një person. Djegia dhe prerja e pyjeve, sidomos ajo e Kodër Krastës së Vogël apo edhe në Njësitë kodrinore-malore mbetet problematike në bashkinë Elbasan.



DEMOKRACIA VENDORE

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Në të gjitha forumet u theksua se janë shumë të kënaqur me nivelin e informimit dhe komunikimit nga administratorët ose përfaqësuesit e Bashkisë. Në mënyrë të veçantë theksuan lehtësinë në marrjen e dokumentave brenda ditës, apo edhe në lehtësimin që iu është bërë gjatë regjistrimit online tek e-albania. Informacioni përcillet në kohë reale dhe për të gjithë është mjaft i qartë dhe i kuptueshëm. Kryetarët e fshatrave janë një mbështetje e madhe e Bashkisë Elbasan, në përcimin e informacionit ose edhe lehtësimin e problematikave që lidhen me komunikimin dhe informimin.

TRANSPARENCA NË VENDIMARRJE

Bashkia përdor një sërë mundësishë për të bërë publike aktivitetet e saj, sipas pjesëmarrësve në forume. Vlerësimi i tyre për nivelin e transparencës së Bashkisë ishte i lartë, por mbetet ende për t'u përmirësuar transparenca online e Bashkisë. Programi i transparencës në web-in e Bashkisë, ka nevojë të përmirësohet dhe të bëhet i kuptueshëm dhe i thjeshtë për t'u aksesuar nga të gjithë qytetarët.

PJESËMARRJA NË VENDIMARRJE

Takimet publike të shpeshta që ndërmerr Bashkia janë forma më e përhapur, që sipas pjesëmarrësve në forume, i bënte ata të përfshihen në vendimarrje. Megjithatë, "Mendimin ne e shprehim, por sa e marrin parasysh këtë nuk e dimë." – thanë disa pjesëmarrës në një prej forumeve. Shumë pak pjesëmarrës ishin të informuar mbi faktin që mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura dhe të drejtën që komuniteti ka për t'i ndjekur këto mbledhje.

